

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Dragashit z. Salim Jonuzi**

I nderuari z. Jonuzi,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Ndërtimin e shkollave të reja dhe pajisjen e shkollave me kabinete;
- Ndërtimin e godinës së Shkollës së Mesme Profesionale, në vlerë rreth 2 milionë euro;
- Ngritjen e cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë;
- Pajisjen e QKMF-ve me barna të nevojshme;
- Vënien në funksion të disa punkteve shëndetësore, disa prej të cilave do të punojnë 24 orë, si në Bresanë, Restelicë, etj.;
- Asfaltimin e rrugëve të çdo lokaliteti të komunës;
- Asfaltimin e rrugës Zaplluxhe-Tetovë;
- Ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës Restelicë-Mavrovë;
- Ujësjiellësin dhe kanalizimin nëpër të gjitha fshatrat;
- Fillimin e ndërtimit të hidrocentralit të Zhurit;
- Zhvillim ekonomik;
- Hapjen e 500 vendeve të reja të punës;
- Pamjen më urbane të qytetit;
- Ndërtimin e qendrës së biznesit;
- Vendosjen e tregut në një vend të caktuar;
- Mundësimin e linjave më të shpeshta të autobusëve në relacionin Prizren-Dragash;
- Hapjen e rrugëve nëpër kullota dhe ndërtimin e lugjeve për pije;
- Ndërtimin e hallës sportive, me kapacitet për deri në 1500 shikues, e cila do të kushtoj rreth 800,000 euro;
- Ndërtimin e terreneve të hapura sportive (brenda 2 viteve);
- Përkrahjen për krijimin e klubeve futbollistike;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)